

## SCREENING OF GLAUCOMA ON 2015 YEAR

**Iljaz Ismaili**  
**Emilija Gjosheska-Dashtevska**  
**Nadi Rustemi**  
**Hristijan Duma**  
**Strahil Gazepov**  
**Gazmend Mehmedi**

**Abstract:** Glaucoma is optic nerve neuropathy with characteristic view of the optic nerve disc followed by damage of visual field, which frequently but not always is associated with high intraocular pressure. Glaucoma is a group of diseases characterized by irreversible loss of the ganglionar retinal cells and neurons which bear visual information from the retina to the visual centers in brain. According to WHO in the world are 450 million blind and 180 million with impaired sight, more in developed countries where the total number of glaucoma is 1-2%. Since glaucoma is ranked as second in the list of ophthalmologic diseases with high morbidity to blinding of population and therefore the interest and commitment of societies for early detection and adequate treatment of this diseases in order to prevent eventual blindness as final result of the diseases undiagnosed and untreated at time.

**Aim:** To raise the level of awareness among citizens for the disease which is also known as “silent killer of the sight”, information on factors of risk that are associated with IOP, lifestyle, heritage, associated diseases, age, sex etc. For early detection, prevention and adequate treatment.

**Material and methods:** Retrospective analysis of data from screening organized in Skopje on 13.03.2015, during World week of Glaucoma. Screening week was organized at city square, where were done measurement of intraocular pressure with Keller type non-contactable. During the action were examined 364 causal passers whose intraocular pressure was measured and an questionnaire of risk was fulfilled. The results are presented in absolute numbers, percentages, tables and graphs.

## SKRININGU I GLAUKOMES NË VITIN 2015

**Iljaz Ismaili**  
**Emilija Gjosheska-Dashtevska**  
**Nadi Rustemi**  
**Hristijan Duma**  
**Strahil Gazepov**  
**Gazmend Mehmedi**

**Hyrje:** Glaukoma është neuropati e nervit optic me pamje karakteristike të diskut të nervit optic e përcjellë me dëmtime të fushës vizive, e cila shpesh por jo gjithmonë është e lidhur me shtypjen intraokulare të ritur. Glaukoma paraqet një grupë të sëmundjeve që karakterizohet me humbje ireverzibile të qelizave ganglionare të retinës dhe neuroneve që bartin informacionet vizuale nga retina në qendrat vizive në tru. Sipas të dhënave të OBSH në botë ka 45 milion të verbër dhe 180 milion me të pamur të dëmtuar, më tepër në vendet në zhvillim ku arinë në 1-2% e numrit të përgjithshëm të popullatës. Pasi që glaukoma është e radhitur e dyta në listën e sëmundjeve oftalmologjike me morbiditet të lartë për verbimin e popullatës prandaj edhe interesimi dhe angazhimi i shoqatave për diagnostikimin e hershëm dhe trajtimin adekuat të kësaj sëmundjeje, me qëllim të parandalimit të verbimit si rezultat përfundimtar i sëmundjes së pardiagnostikuar dhe pamjekuar në kohë.


**Qëllimi:** Të ngritet niveli i vetëdijes tek qytetarët për sëmundjen e cila ndryshe quhet edhe si “vrasësi i heshtur i pamurit”, informimi për faktorët e rizikut që janë të lidhur me IOP, stilin e jetës, trashigimin, sëmundjet përcjellëse, moshën, gjinia etj. Për zbulimin e hershëm, parandalimin dhe trajtimin adekuat.

**Materiali dhe metodat:** Analiza retrospective e të dhënave nga skringu i organizuar në qytetin e shkupit më 13.03.2015, gjat javës botërore të glaukomës. Skringu u organizua në sheshin e qytetit, ku bëhej matja e tensionit intraocular me tensiometër të tipit Keller jokontaktibël. Gjatë aksionit u ekzaminuan 364 kalimtar të rastit të cilëve u mat tensioni intraocular dhe plotsuan pyetësorin për faktorët tjerë të rizikut. Rezultatet janë paraqitur në numra absolute, përqindje, tabela dhe grafikone.

**REZULTATET**

Në punimin tonë janë rezultatet e skriningut të 364 kalimtarëve të rastit dhe plotësuar pyetësori.


Tabela1-Tregon numrin e të ekzaminuarve sipas gjinisë;



Gjinia	
M	253 (70%)
F	111 (30%)

Në tabelën 1 është paraqitur pjesëmarja e kalimtarëve sipas gjinisë; Ku vërehet se 253 ose 70% kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe 111 ose 30 të gjinisë femërore.

Tabela 2-tregon grupimin e të ekzaminuarve të ndarë në disa grupmosha:





Grupmosha	
1930 - 1940 (80)	56 (15.38%)
1941 - 1950 (70)	151 (41.48%)
1951 - 1960 (60)	90 (24.72%)
1961 - 1970 (50)	43 (11.81%)
1971 - 1980 (40)	13 (3.57%)
1981 - -----> (30)	11 (3.03%)

Në tabelë është treguar se 56 të ekzaminuar ose 15.38% kanë qenë të grupmoshës 1930-1940; 151 të ekzaminuar ose 41.48 të grupmoshës 1941-1950 ; 90 të ekzaminuar ose 24.72% të grupmoshës 1951-1960; 43 të ekzaminuar ose 11.81% të grupmoshës 1961-1970 ; 13 të ekzaminuar ose 3.57% të grupmoshës 1971-1980 ; dhe 11 të ekzaminuar ose 3.03% grupmoshës më të re se 1981.

Tabela 3-Janë të paraqitura rezultatet nga pergjigjija në pyëtjen a din dicka për glaukomën:

A keni degjuar per Glaucomen		
Po	229 (63%)	
	M	F
	147 (58%)	84 (75%)
Jo	135 (37%)	
	M	F
	108 (42%)	27 (25%)








Rezultatet tregojnë se nga numri i përgjithshëm prej 364 të ekzaminuar, 229 ose 62.9% (147 ose 53.3% meshkuj dhe 84 ose 75% femra) kanë qenë të njohuar për sëmundjen dhe 135 ose 37.1% (108 ose 42.7% meshkuj dhe 27 ose 25% femra) s'kanë ditur për sëmundjen.

Tabela 4-Janë paraqitur rezultatet nga përgjigjja në pyetjen a vujnë nga sëmundja e diabetit, njëra nga faktorët e rezikut;




Diabet	
Po	66
Jo	298



Rezultatet treguan se nga numri i përgjithshëm prej 364 të ekzaminuarve 66 vetë ose 18.2% kanë qenë të sëmurë nga diabeti (47 ose 19.0% meshkuj dhe 19 ose 17.1% femra) dhe 298 ose 81.8% (206 ose 81.0% meshkuj dhe 92 ose 82.9% femra) s'kanë pasur diabet.

Tabela 5- Janë paraqitur rezultatet nga pyetja a kanë ndonjë anomali refractive gjegjësisht myopia.




Anomali ne refrakcion (Myopia)	
Po	104
Jo	260



Rezultatet treguan se nga numri i përgjithshëm prej 364 të ekzaminuarve 104 ose 28.6% (63 ose 25.0% meshkuj dhe 41 ose 37.0% femra) janë miop dhe 260 ose 71.4% (190 ose 75% meshkuj dhe 70 ose 63.0% femra) s'kan pasur myopi.



Tabela 6- janë paraqitur rezultatet e pyetjes a vuajnë nga tension ii lartë i gjakut HTA.

HTA	
Po	163
Jo	201





Rezultatet treguan se nga numri i përgjithshëm prej 364 të ekzaminuarve 163 ose 44.78% (106 ose 42.0% meshkuj dhe 57 ose 51.4% femra)vuajnë nga HTA dhe 201 ose 55.22% (147 ose 58.0% dhe 54 ose 48.6% femra) s'kan vuajtur nga HTA.

Tabela 7-Janë paraqitur rezultatet në pyetjen a konsumojn duhanin.




Rezultatet treguan se nga numri i përgjithshëm prej 364 të ekzaminuarve 59 vetë ose 16.2% (38 vetë ose 15.02% meshkuj dhe 21 vetë ose 18.9% femra) konsumojn (pijnë) duhan-cigare dhe 305 vetë ose 83.8% (215 vetë ose 84.98% meshkuj dhe 90 vetë ose 81.1%) s'pijnë cigare.

Tabela 8- Janë paraqitur rezultatet e përgjigjes në pyetjen a kan pasur ndonjëherë ndonjë lëndim të syrit.



Rezultatet treguan se nga numri i përgjithshëm prej 364 të ekzaminuareve 34 vetë ose 9.3% (27 vetë ose 10.9% meshkuj dhe 7 ose 6.3% femra) gjatë jetës së tyre kanë pasur ndonjë lëndim të syrit dhe 330 vetë ose 90.7% (226 vetë ose 89.1% meshkuj dhe 104 vetë ose 93.7% femra) s'kan dijeni për ndonjë lëndim të mundshëm në sy.

Tabela 9-janë paraqitur rezultatet e matjes së IOP të ndarë në disa grupe.



Rezultatet treguan se nga 728 sy ku është bërë matja 361 sy ose 49.6% (253 ose 50% e meshkujve dhe 108 ose 48.7% e femrave) kanë qenë në grupën me IOP 10-17mmHg; 247 sy ose 33.9% (166 sy ose 32.8% meshkuj dhe 81 sy ose 36.5% femra) në grupën me IOP 18-20mmHg; 70 sy ose 9.6% (52 sy ose 10.8% meshkuj dhe 18 sy ose 8.15% femra) në grupën me IOP 21-22mmHg; 19 sy ose 2.6% (12 sy ose 2.4% meshkuj dhe 7 sy ose 3.15% femra) në grupën me IOP 23-24mmHg; dhe 31 sy ose 4.3% (23 sy ose 4.0% meshkuj dhe 8 sy ose 3.5% femra) në grupën me IOP 25mmHg dhe më të lartë.

### DISKUTIMI

Akcionin është ndërmarë gjatë javës botërore të glaukomës më 13.03.2015 në qendër të Shkupit. Gjatë kësaj periudhe matjes së tensionit intraocular I janë nënshtruar 364 kalimtarë të rastit, prej tyre 253 (70%) meshkuj 111 (30%) femra. Tek 29 prej tyre janë zbuluar vlera të ritura të tensionit intraocular. Sa I përket faktorëve të rezikut numri më i madh i kalimtarëve 161 vuanin nga HTA, kurse 267 prej tyre kishin një ose më tepër faktorë të rezikut për shfaqjen e glaukomës

Glaukoma është sëmundje multifaktoriale që shkakton verbim të sigurtë nëse nuk diagnostikohet dhe mjekohet me kohë.

Glaukoma sipas rezultateve tona I prek të gjitha moshat, më e shprehur është në moshat mbi 40 vjeç (1,2,3,7,8) I prek të dy gjinitë më e shprehur tek gjinia femrore (1,2,7,8). Në të shumtën e rasteve zbulohet rastësisht gjysma

(4,6). Informimi i popullatës është i ulët sa i përket sëmundjes edhe pse nga anketimi del se 147 meshkuj (58% e tyre) dhe 84 femra (75% e tyre), ku mund të vërehet se gjinia femërore është më e informuar sa i përket njohurive për sëmundjen. Faktorë tjetër i rizikut është sëmundja e diabetit (5,4,2,1), ku rezultatet e anketimit treguan se 66 kalimtarë nga gjithsejt 364 (18%) vuanin nga diabeti sipas gjinive 47 (19%) meshkuj dhe 19 (17%) femra vuanë nga diabeti. Faktorë tjetër i rizikut është hipertensioni arterial (HTA) (1,2,3,4,5), ku nga grupa e anketuar rezultoi se 163 ose 44,78% vuajnë nga HTA, incidence më e madhe tek gjinia femërore sipas gjinive 106 meshkuj ose 42% vuajnë nga HTA dhe 57 femra ose 51,4% vuajnë nga HTA. Faktori tjetër i rizikut myopia (1,2,3,4,5), rezultatet tona treguan se 104 ose 29% vuajnë nga myopia sipas gjinive 63 (25%) meshkuj dhe 41 (37%) femra vuajnë nga myopia. Faktorë tjetër i rizikut duhanpirja (5), nga rezultatet tona del se 59 vetë ose 16% pinë duhan, sipas gjinive 38 (15%) meshkuj dhe 21 (19%) femra pijnë duhan. Faktor tjetër i rizikut lëndimet e mëhershme në sy ku nga rezultatet tona del se 34 (9%) e të anketuarve kanë pasur ndonjë lëndim të syrit edhe atë 27 (11%) meshkuj dhe 7 (6%) femra. Sipas rezultateve të matjes së IOP u zbuluan 35 vetë të dyshimtë që duhet të përcjellen në institucione adekuate dhe 25 vetë ose 50% me prezencë të sëmundjes së glaukomës.

#### Përfundimi

Glaukoma është sëmundje-neuropati e mbaresave nervore të retinës dhe n.optik e cila zhvillohet qetë dhe shpesh diagnostikohet rastësisht mbasi janë bërë ndryshime ireverzibile. Prandaj shoqata e glaukomatologëve dhe oftalmologëve kanë ndërmarë një mori aksionesh për ngritjen e vetëdijes të qytetarëve për prezencën e sëmundjes, faktorët e rizikut, mënyrën e diagnostikimit. Si rezultat kemi organizimin e javës botërore të glaukomës me skrining falas për të gjithë.

Nga mostra jonë vijmë në përfundim se sëmundja e glaukomës është prezente tek ne, i prek të gjitha moshat më tepër moshat mbi 40 vjeç, i prek të dy gjinitë me incidencë pak më të lartë gjininë femërore, faktorët e rizikut janë present dhe kanë ndikim në shfaqjen e sëmundjes.

#### REKOMANDIMET

Vetëdijësimi i popullatës për sëmundjen, faktorët e rizikut dhe pasojat ireverzibile për dëmtimin e të pamurit.

Pacientët të njohtohen me faktorët e rizikut, të kontrollojnë ato dhe të kërkojnë ndihmë profesionale.

Pacientët e moshës mbi 40 vjeç të kontrollohen së paku një herë në vit tek oftalmologu.

Pacientët e diagnostikuar me IOP më të lartë se normalja të jenë në kontrollë të vazhdueshme të oftalmologut, pacientët që kanë dallim të theksuar të IOP në mes të dy syve duhet të kërkojnë kontrollë tek oftalmologu-glaukomatolog.

#### REFERENCAT

- [1] UKCRS-mojabanjaluka.info/infograda/clanak/11853/sumnja-na-glaukom-kod-16-pacienata.
- [2] WWW.glassrpske.com/drustvo/vjesti-glaukom-nije-imalo-vecina-pregledanih/lat/178126html
- [3] svjetska- nedjela-glaukoma-2015-u-crnoj-gori/ BY-EDITA FILES BRADARIC april 15, 2015. crnogorsko oftalmolosko drustvo (svetska nedelja glaucoma 2015).
- [4] Vrednosta na ocniot pritisok kako factor na rizik za zaboluvanje od glaukom ispituvan preku javno-zdravstvena akcija za rano otkrivanje na bolesta. Magisterski trud- Univerzitet Sveti Kiril I Metodij- Medicinski fakultet Skopje-2012 autor Violeta Jakimovska.
- [5] WWW.kcus.ba/obiljezana-svjetska-sedmica-borbe-protiv-glaukoma
- [6] Naza Mujkic (<http://ekonferencije.com/sr1/autor/naza-mujkic/1885>)
- [7] Glaukom kao javnozdravstveni problem-diplomski rad autor Bruno Markioli 2017-Sveuciliste u Splitu Medicinski Fakultet